



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-128
Prishtinë, më 25 nëntor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 25 NËNTOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Naim Maloku, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Slobodan Petrović dhe Numan Baliq, anëtarë të Kryesisë;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri dhe Shefki Shoshaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pik shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 nëntor 2010,

2. Shqyrtimi i kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 nëntor 2010,

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 nëntor 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi Raportin e lartcekur, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2010.

3. Bartja e mjeteve buxhetore nga grupet parlamentare në fondin e partive politike

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupeve Parlamentare, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Grupeve Parlamentare për bartjen e mjeteve të mbetura nga ky fond në fondin e mjeteve të partive politike, për vitin 2010.

2. Ngarkohen Partitë Politike që në marrëveshje me shefat e Grupeve Parlamentare, ti përmbushin të gjitha obligimet e pa paguara të grupeve parlamentare, ku përfshihen pagat e asistentëve dhe shërbimet e furnizimet tjera, për vitin 2010.

4. Kërkesa e ish-deputetit, Xhelal Canziba, për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit

Kryesia, pasi shqyrtoi sërish kërkesën e ish-deputetit, Xhelal Canziba, për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit konstatoi sërish se në mungesë të mjeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga vija buxhetore për këtë destinim, ti rekomandohet Ministrisë së Shëndetësisë, që të shqyrton mundësin e kompensimit të shpenzimeve të shërimit ish-deputetit Xhelal Canziba nga Fondi i mjeteve të destinuara për shërimin e pacientëve jashtë vendit.

5. Kërkesa e Avokatit të Popullit për përkrahje financiare lidhur me mbajtjen e një konference ndërkombëtare në Prishtinë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Avokatit të Popullit për përkrahje financiare lidhur me mbajtjen e konferencës ndërkombëtare në Prishtinë, mori këtë

V E N D I M

Miratohet pjesërisht kërkesa e Avokatit të Popullit për përkrahje financiare lidhur me mbajtjen e konferencës ndërkombëtare në Prishtinë, dhe atë në shumën prej 2.660,00 €, vetëm për akomodim të mysafirëve, me prezantim të faturës së hotelit.

Pika shitesë:

6. Kërkesa për ridestinimin e mjeteve nga projekti Vila Gërmia për projektin e ri për renovimin e sallës C-301

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Sekretarit të Kuvendit për ridestinimin e mjeteve nga projekti Vila Gërmia për projektin e ri për renovimin e sallës C-301, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Sekretarit të Kuvendit për ridestinimin e mjeteve nga projekti Vila Gërmia për projektin e ri për renovimin e sallës C-301, në Kuvendin e Kosovës, në shumë prej 28.536,00 euro.

2. Vendimi i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, për miratim përkatësisht që të lejon bartjen e mjetet sipas pikës nr. 1 të këtij vendimi.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale